



UNIVERSITETI "KADRI ZEQA"
UNIVERSITY "KADRI ZEQA"

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.upgj.org tel: 0280390112

Ref. nr. 07/505 Dt. 11 / 06 /2014

RREGULLORE

për formimin e komisioneve për pranimin e studentëve të rinj në UKZ

Gjilan, qershor 2014

Në mbështetje të nenit 23 paragrafi 1 pika 1.3 dhe 1.6/3 të Statutit të Përkohshëm të Universiteti, Këshilli i Përkohshëm i Universiteti "Kadri Zeka" në mbledhjen e mbajtur më 11.06.2014, nxori

Rregullore për formimin e komisioneve për pranimin e studentëve të rinj në UKZ

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e formimit të komisioneve dhe punonjësve të tjerë të cilët janë angazhuar në mënyrë aktive gjatë pranimit të studentëve në Universitetin "Kadri Zeka" Gjilan.

Neni 2

Universiteti formon një komision në nivel të Rektoratit i cili do të përkujdeset për mbarëvajtjen e procesit me rastin e pranimit të studentëve të ri, si dhe do të kryejë punë dhe detyra të tjera nga fushëveprimtaria e kompetencave të tij.

Neni 3

Komisioni i formuar në nivel të Rektoratit është në përbërje:

1. Rektori
2. Prorektorët
3. Sekretari i Përgjithshëm dhe
4. Një nga stafi administrativ

Kryetar i këtij komisioni është Rektori i Universitetit.

Neni 4

Komisioni sipas nenit 3 është me kompetenca vendimmarrëse për çështje të ndryshme që shtrohen gjatë realizimit të konkursit për pranimin e studentëve, si dhe vendosë për ankesat e kandidatëve në instancë të dytë pas vendimeve të marra nga njësitë akademike.

Neni 5

Në kuadër të njërive akademike, formohen komisione në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve, në krye të cilit qëndron kryetari i komisionit përkatës.

Neni 6

Në kuadër të komisioneve sipas nenit 5, hyjnë:

- komisioni për përpilimin e testeve, i caktuar nga dekani;
- komisioni për vlerësimin apo kontrollimin e testeve, i caktuar nga dekani;
- komisioni për ankesa në shkallë të parë në kuadër të njësive akademike në përbërjen e cilit është dekani dhe dy anëtarë të tjerë.

Neni 7

Pjesëmarrës të tjerë në procesin e pranimin të studentëve të rinj konsiderohen: zyrtarët për pranimin e dokumenteve, zyrtarët e IT – që shërbejnë në proces dhe zyrtarët për përgaditjen teknike të testeve (fotokopjimi, lidhja, vulosja) etj.

Neni 8

Ky nen përcakton personat që janë të kyqur drejtpërdrejt apo tërthorazi sa i përket kontributit të tyre të dhënë, në realizimin e konkursit për pranimin e studentëve të rinj. Duke përfshirë menaxhmentin, anëtarët e komisioneve dhe zyrtarët e shërbimeve:

1. Kryetar i komisionit qendror – Rektori;
2. Anëtar i komisionit qendror – Prorektori;
3. Anëtar i komisionit qendror – Sekretari i përgjithshëm;
4. Anëtar i komisionit qendror – përfaqësuesi i administratës;
5. Udhëheqësi i njësisë akademike (kordinatori);
6. Kryetar i komisionit për përpilimin e testeve;
7. Anëtarët e komisioneve për përpilimin e testeve;
8. Kryetar i komisionit për kontrollimin e testeve;
9. Anëtarët e komisioneve për kontrollimin e testeve
10. Kryetar i komisionit për ankesa në kuadër të njësisë akademike;
11. Anëtar i komisionit për ankesa në kuadër të njësisë akademike;
12. Zyrtarët për pranimin e dokumenteve;
13. Zyrtarët e IT-së, për futjen e pikëve në sistem dhe rangimin;
14. Zyrtarët e tjerë për përgaditjen teknike të testeve dhe kujdestarët e sallave ku mbahet testi.

Neni 9

Menaxhmenti propozon shumën për pagesë të komisioneve dhe zyrtarëve, kurse KPD duhet ta miratojë atë.

Neni 10

Pagesa për provim pranues në Fakultet do të bëhet sipas Udhëzimit Administrativ të Maht-it, nr.17/2014 .

Poqëse numri i të paraqiturve në konkurs është i vogël dhe pagesa e anëtarëve të komisionit bëhet e pamundur, atëherë menaxhmenti duhet të sigurojë mjete shtesë nga fondet e alokuara për këtë qëllim, pas marrjes së pëlqimit nga KPD.

Neni 13

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga KPD.

Mënyra e ndryshimit të kësaj Rregullore është e njëjtë me atë të nxjerrjes.

- Kjo Rregullore u aprovua në mbledhjen e XII të KPD, e mbajtur më 11.06.2014.

Gjilan, qershor 2014



Kryetar i KPD
Arben Dermaku
Prof.Ass.Dr. Arben Dërmaku